



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. regjistri (JR) 11/2018,  
datë 03.09.2018

Tiranë më 03.10.2018

**SHPALLJE**  
**E**  
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e martë, në datën 23.10.2018, ora 10:00, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja nr. (JR) 11/2018, datë 03.09.2018, për ankimin që subjekti i rivlerësimit Luan Kaloçi ka bërë kundër vendimit nr. 33, datë 05.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesues i Trupit Gjykses</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>
<b>Relator i Çështjes</b>	<b>Natasha Mulaj</b>
<b>Gjyqtar</b>	<b>Ardian Hajdari</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Ina Rama</b>
<b>Gjyqtar</b>	<b>Luan Daci</b>

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**RELATORI I ÇËSHTJES**  
**GJYQTARE**  
**Natasha Mulaj**

**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARE**  
**Rezarta Schuetz**